

P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

**" Qeverisja lokale bazohet në parimet si: sundimi i ligjit, përgjegjësia,
llogaridhënia, besimi, transparencja, efektiviteti, efikasiteti,
partneriteti dhe koherenca."**

Përmbajtja

P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	3
3. Funksionet:	4
3.1. F1. Administrata vendore	4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	6
3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2	9
3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O3.	10
4. Buxhetimi i programit të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)	11
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim);	13

P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

1. Hyrje

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

2. Politikat e zhvillimit

Qeverisja jonë lokale do të bazohet në parimet e sundimit të ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.

Meqënëse qeverisja e mirë ndërlihet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, e cila do të zbatohet nga administrata e bashkisë së Shkodrës do të jenë:

I. Krijimi i një strukture menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

III. Dixhitalizmi i administratës publike do të jetë një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore, tashmë në një shtrirje të re territoriale. Qytetari do të ketë mundësi që për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia e Shkodrës, të aplikojë dhe përfitojë shërbimin në çdo Njësi Administrative.

3. Funksionet:


3.1. F1. Administrata vendore

F1.01 Burime Njerezore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

Situata e vlerësuar në fund te vitit 2016:

- Strukturë e burimeve njerëzore funksionale në përmbushje të detyrimeve dhe funksioneve e kompetencat për pushtetin vendor;
- 11 Njësi administrative;
- Institucione të varësisë;

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Përmirësimi i qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore.	Përmirësimi i qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore.	Përmirësimi i qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore.
Rekrutimi i Administratës Vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësiwe profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve.		
Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.	Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.	Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.



3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P1.F1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	208,701
P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	150
P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës	200

F1.O2. Sigurimi i Shërbimeve mbështetëse për mirëfunjionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Është përmirësuar funksionimi normal i administratës përsa i përket ofrimit dhe mbështetjes financiare të shërbimeve mbështetëse bazë.
- Është siguruar funksionimi i 11 (njëmbëdhjetë ndërtesave administrative të Bashkisë Shkodër.
- Është kryer mirëmbajtja e objekteve ndërtimore: Zyrat e drejtorise Juridike dhe Aseteve, magazina e bashkise, riparimi i tarraces se Z1N, lysterja e zyrave te gjndjes civile dhe 35 zyrave te administrates se bashkise dhe NJA. Rikonstruktuar dhe përmirësuar kushtet e infrastruktures se godines administrative te NJA Gur i Zi.
- Po realizohet projekti i rikonstruksionit të rrjetit elektrik në godinën në qendër të Bashkisë.
- 109 (njëqind e nëntë) aplikime për regjistrimin e pronave të paluajtshme publike të Bashkisë së Shkodrës: 141 (njëqind e katërdhjetë e një) prona publike për të cilat nuk ka nisur procesi i regjistrimit.
- Shërbimi Internetit aktualisht ofrohet në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje).
- Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i shtrirë në Bashkinë Qendër dhe 7 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Postribë dhe Rrethina).
- Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV) në Bashkinë Shkodër, instrument për implementimin e një regjistri elektronik të të ardhurave vendore.
- Pajisje TIK të reja dhe egzistuese të mirëmbajtura në shërbim të administratës vendore.
- Portal zyrtar interneti në shërbim të qytetarëve.
- Likuidim i vendimeve të gjykatës së formës së prerë, sipas procedurave dhe rregullave financiare të ekzekutimit të tyre për Bashkinë Shkodër.
- Çatia e godinës së Bashkisë e amortizuar.
- Mungesa e mjeteve transportuese për strukturën e Policisë bashkiake dhe për lëvizjen e stafit në zonat malore.
- Ofrim materiale shërbime mbështetëse.
- Infrastruktura fizike e komunikimit elektronik mungon në 3 Njësi Administrative dhe në 5 Lagjet.
- Komunikim përmes shërbimit telefonik fiks.
- Vëzhgimi dhe kontrolli i aksesit në Njësi Administrative dhe lagje.
- Sistem analog konference në sallën e Këshillit të Bashkisë Shkodër.
- Ofrimi i shërbimeve administrative me SiZ1N dhe i tarifave dhe taksave vendore me SiTTV në sportelet e Bashkisë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagjeve.

- Të dhëna gjeoreferuese, financiare vendore, turistike vendore, shërbime administrative vendore, etj., të pa integruara.
- Sistem analog konference në sallën e Këshillit të Bashkisë Shkodër.
- Janë kryer pagesat dhe shpenzimet sipas parashikimeve të funksioneve e deleguara

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Vazhdimi i përmirësimit të funksionimit normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë.	Vazhdimi i përmirësimit të funksionimit normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë.	Vazhdimi i përmirësimit të funksionimit normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë.
Sigurimi funksionimit të 11 (njëmbëdhjetë ndërtesave administrative të Bashkisë Shkodër.	Sigurimi funksionimit të 11 (njëmbëdhjetë ndërtesave administrative të Bashkisë Shkodër.	Sigurimi funksionimit të 11 (njëmbëdhjetë ndërtesave administrative të Bashkisë Shkodër.
Ndërtesa administrative funksionale dhe në shërbim të administratës vendore	Përmirësim i kushteve në ndërtesat administrative funksionale dhe në shërbim të administratës vendore; Rikonstruksion I rrjetit elektrik në godinën e në qendër të bashkisë Shkodër i përfunduar.	Përmirësim i kushteve në ndërtesat administrative funksionale dhe në shërbim të administratës vendore
Aplikim, marrje e Çertifikatave të pronësisë për pronat të Bashkisë së Shkodrës	Aplikim, marrje e Çertifikatave të pronësisë për pronat të Bashkisë së Shkodrës	Aplikim, marrje e Çertifikatave të pronësisë për 250 (dyqind e pesëdhjetë) prona të Bashkisë së Shkodrës
Shërbim Internetit i integruar në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje) 3-vjeçar.	Shërbim Internetit i integruar në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje) 3-vjeçar.	Shërbim Internetit i integruar në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje) 3-vjeçar.
Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i shtrirë në Bashkinë Qendër dhe 15 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Posttribë, Rrethina, Shalë, Pult, Shosh dhe 5 Lagje).	Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i përmirësuar në Bashkinë Qendër dhe 15 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Posttribë, Rrethina, Shalë, Pult, Shosh dhe 5 Lagje).	Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë i përmirësuar në Bashkinë Qendër dhe 15 Njësi Administrative (Dajç dhe Velipojë, Anë të Malit, Bërdicë, Guri Zi, Posttribë, Rrethina, Shalë, Pult, Shosh dhe 5 Lagje).
Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV) në Bashkinë Shkodër, i testuar dhe përshtatur për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.	Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV) në Bashkinë Shkodër funksional dhe për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.	Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV) në Bashkinë Shkodër funksional dhe në vazhdimësi i përditësuar dhe për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Infrastrukturë pajisjesh TIK të mirëmbajtura dhe të reja në shërbim të administratës vendore.	Infrastrukturë pajisjesh TIK të mirëmbajtura dhe të reja në shërbim të administratës vendore.	Infrastrukturë pajisjesh TIK të mirëmbajtura dhe të reja në shërbim të administratës vendore.
Portal zyrtar interneti e strukturuar, informues dhe gjithnjë drejt e-shërbimeve dhe të dhënave të hapura (Open Data)	Portal zyrtar interneti e strukturuar, informues dhe gjithnjë drejt e-shërbimeve dhe të dhënave të hapura (Open Data)	Portal zyrtar interneti e strukturuar, informues dhe gjithnjë drejt e-shërbimeve dhe të dhënave të hapura (Open Data)
Realizimi I shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore	Realizimi I shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore	Realizimi I shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore
Përmirësimi i kushteve në infrastrukturë për administratën.	Përmirësimi në vazhdimësi i kushteve në infrastrukturë për administratën.	Përmirësimi në vazhdimësi i kushteve në infrastrukturë për administratën.
Krijimi i kushteve me qëllim që të ushtrohen funksionet në shërbim të transportit te stafit	Krijimi i kushteve me qëllim që të ushtrohen funksionet në shërbim të transportit te stafit	Krijimi i kushteve me qëllim që të ushtrohen funksionet në shërbim të transportit te stafit
Sigurimi i materialeve bazë për punonjësit mbështetës	Sigurimi i materialeve bazë për punonjësit mbështetës	Sigurimi i materialeve bazë për punonjësit mbështetës
Infrastrukturë fizike optimale për një komunikim elektronik të sigurtë mbi të cilin sigurohet puna e administratës vendore dhe ofrimi i shërbimeve elektronike administrative në të gjithë Bashkinë.	Infrastrukturë fizike optimale për një komunikim elektronik të sigurtë mbi të cilin sigurohet puna e administratës vendore dhe ofrimi i shërbimeve elektronike administrative në të gjithë Bashkinë.	Infrastrukturë fizike optimale për një komunikim elektronik të sigurtë mbi të cilin sigurohet puna e administratës vendore dhe ofrimi i shërbimeve elektronike administrative në të gjithë Bashkinë.
Implementim i sistemit te integruar të komunikimit të dokumentacionit, të funksioneve dhe detyrave të administratës publike i bazuar në shërbimin e internetit.	Sistem i integruar funksional të komunikimit të dokumentacionit, të funksioneve dhe detyrave të administratës publike i bazuar në shërbimin e internetit. Implementimi i sistemit të vëzhgimit dhe kontrollit të aksesit në Njësitë Administrative dhe Lagjet, të integruar me Bashkinë Qendër Implementimi i sistemit të regjistrimit Video FULL HD në mbledhjet dhe aktivitetet e Sallës së Këshillit të Bashkisë Shkodër	Sistem i integruar funksional të komunikimit të dokumentacionit, të funksioneve dhe detyrave të administratës publike i bazuar në shërbimin e internetit.

	Ofrimi i shërbimeve administrative me SiZ1N dhe i tarifave dhe taksave vendore me SiTTV përmes portalit zyrtar të internetit ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe portalit e-Albania	Ofrimi i shërbimeve administrative me SiZ1N dhe i tarifave dhe taksave vendore me SiTTV përmes portalit zyrtar të internetit ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe portalit e-Albania
	Implementim i sistemit të informacionit GIS i integruar i të dhënave vendore si: SiZ1N, SiTTV, baza të dhënash shtetërore RKGJC, QKB, etj.	Sistemi funksional i informacionit GIS i integruar i të dhënave vendore si: SiZ1N, SiTTV, baza të dhënash shtetërore RKGJC, QKB, etj. Implementimi i sistemit të përkthimit simultan në mbledhjet dhe aktivitetet e Këshillit të Bashkisë Shkodër.
<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara 	Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara	Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara

3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	6,880
P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës.	10,800
P1.F1.O2.A3 Shërbim higjeno-sanitar për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	100
P1.F1.O2.A4 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj).	1,000
P1.F1.O2.A5 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës	4,610
P1.F1.O2.A6 Organizimi i pritjeve të perfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja.	1,400
P1.F1.O2.A7 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë	300
P1.F1.O2.A8 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës	800
P1.F1.O2.A9 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës	800
P1.F1.O2.A10 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës	1,700
P1.F1.O2.A11 Rikonstruksion i rrjetit elektrik të godinës në qendër të Bashkisë së Shkodrës	7,000
P1.F1.O2.A12 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	600
P1.F1.O2.A13 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër	2,500
P1.F1.O2.A14 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	2,100
P1.F1.O2.A15 Zgjerimi i plotë dhe mirëmbajtje 3-veçare e Sistemit të Integruar të	2,710

Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N -Smart Processes Enterprise)	
P1.F1.O2.A16 Mirembajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV)	-
P1.F1.O2.A17 Mirëmbajtje 3-vjeçare pajisje Informatike	300
P1.F1.O2.A18 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	5,000
P1.F1.O2.A19 Mirëmbajtje 3-vjeçare e faqes zyrtare ëeb ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj.	300
P1.F1.O2.A20 Detyrime dhe kompensime legale	
P1.F1.O2.A21 Rikonstruksion çatia e godinës së bashkisë	9,970
P1.F1.O2.A22 Blerje automjete në funksion të administratës	1,600
P1.F1.O2.A23 Blerje vegla pune	200
P1.F1.O2.A24 Ndërtimi i rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik (intranet) në 3 Njësi Administrative dhe 5 Lagje	2,240
P1.F1.O2.A25 Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendëruar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud.	1,000
P1.F1.O2.A32 Shërbimet e deleguara të QKR dhe Gjendja Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative)	18,119

F1.03 Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.

Situata e vlerësuar në fund te vitit 2016:

- 51 anëtarë të këshillit vendor dhe 110 kryepleq mbështeten për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi;

Situata e synuar 2017

Situata e synuar 2018

Situata e synuar 2019

51 anëtarë të këshillit vendor dhe 110 kryepleq mbështeten për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi.

51 anëtarë të këshillit vendor dhe 110 kryepleq mbështeten për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi.

51 anëtarë të këshillit vendor dhe 110 kryepleq mbështeten për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi.

3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.03.

Aktiviteti

Buxheti në mijë lekë

P1.F1.O3.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepleqtë)

16,327


4. Buxhetimi i programit të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim), planifikohet buxheti me vlerë totale 308,087 mijë lekë ndër të cilat 74% paga dhe sigurime shoqërore, 17 % shpenzime operative dhe 9 % investime.

Tabelë 1 Planifikimi për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Programe P1	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
Plani 2016	247,494	64,062	0	1,137	27,358	340,051
Plani i ndryshuar	219,136	51,685	0	2,627	30,663	304,111
I pritshmi 2016 12-mujor	178,334	43,802	0	2,162	26,341	250,639
Plani 2017	226,760	52,837	0	680	27,810	308,087
Plani 2018	256,796	57,680	0	680	42,070	357,226
Plani 2019	261,929	58,213	0	680	17,480	338,302

P1. Planifikim Manaxhim Administrim




Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

Tabelë 2 Burimet e financimit për financimin për funksionimin e administratës vendore

P1. Planifikim Manaxhim Administrim	Tr. Pakushtezuar	Ardhura	Tr. Specifike	Donacion	Tr. Kushtezuar	Totali
Paga + Sigurime	104350	104351	0	0	18059	226760
Shpenzime Operative	50067	0	0	2710	60	52837
Subvencioni	0	0	0	0	0	0
Transferta	680	0	0	0	0	680
Investime	25697	0	0	2113	0	27810
total	180794	104351	0	4823	18119	308087

**Burimet e financimit për financimin për Administratën Vendore
(Planifikim, Menaxhim, Administrim)**



Grafik 2 Burimet e financimit për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim);

Nr. 1	<p>Projekti: P1.F1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.</p>	<p>Llojet e programit: P1. Administrim, Menaxhim, Planikim</p> <p>Funksioni: P1. F1 Administrata Vendore</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>• Paga dhe shtesat mbi paga Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016” Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.</p> <p>Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2016, në kuadër të ristrukturimit të struktura, në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe VKM-ve në zbatim të tij ka zhvilluar procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil në lëvizjen paralele dhe pranimit në shërbimin civil. Procedurat kanë vazhduar gjatë gjithë vitit dhe koha e fillimit të punës për punonjësit nuk ka qene qe ne fillim te vitit 2016.</p> <p>Nga kjo fondii pagave dhe sigurimeve shoqerore I planifikuar per vitin 2016, nuk eshte realizuar plotesisht.</p> <p>Planifikimi I fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per vitin 2017 eshte ne shumen 233.701 mije leke. Planifikimi eshte bere duke u bazuar ne shtesen prej 10%, qe eshte deklaruar nga qeveria, ne prezantimin e projektbuxhetit te shtetit per vitin 2017.</p> <p>Duke qene se ka gjendje leke te paperdorura nga viti 2016, per te cilat do te behet rishperndarja pas paraqitjes se realizimit te buxhetit te vitit 2016 ne muajin mars 2017, ne planin e vitit 2017 do te paraqiten per diference paga 181.632 mije leke dhe sigurime shoqerore 27.069 mije leke.</p> <p>Në vitin 2017 struktura e ABshkisë Shkodrës përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 366 punonjës të administratës së Bashkisë së Shkodrës. Brenda këtij numri këtë vit do të mundësohet shtimi i drejtorisë për emergjencën dhe mbrojtjen civile. - Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. - Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24. 12. 1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërbllim sipas rastit 		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<p>Të përmirësojmë qeverisjen lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerzore. Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore të nëpunësve për administratën vendore.</p>		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>		
<p>Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për administratën vendore.</p>		
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</p>		
<p>Shpërbllimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.</p>		
<p>c) Aktorët e mundshëm</p>	<p>d) Kontributet e mundshme në projekt</p>	
<p>1. Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Drejtoria e Financës</p>	<p>Bashkia e Shkodrës</p>	
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</p>		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mije lekë)	Nga kjo:					
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale	
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	181632	181632					
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	27069		27069				
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180		
A4	Transferime tek organizata jofitimprurese	500				500		
Shuma		209 381	181632	27069		680		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mije lekë)	Nga kjo:					
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale	
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	205 665	205 665					
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	32 711		32 711				
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180		
	Transferime tek organizata jofitimprurese	500				500		
Shuma		239 056	205 665	32 711		680		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:					
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale	
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	209 778	209 778					
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	33 365		33 365				
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180		
A4	Transferime tek organizata jofitimprurese	500				500		
Shuma		243 823	209 778	33 365		680		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2017, 2018, 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Drejtorja e Finances 2. Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse						

Nr.2	Projekti: P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	Llojet e programit: P1. Administrim, Menaxhim, Planikim Funksioni: P1. F1 Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
<p>Me zbatimin e Reformës Territoriale, zgjerimin e territorit të Bashkisë Shkodër, ndryshimin e detyrave dhe funksioneve të pushtetit vendor, struktura organizative e institucionit tonë ka pësuar ndryshime. Për shkak të këtyre ndryshimeve, një ndër detyrat më të rëndësishme të programit Administrim, Menaxhim dhe Planifikim ishte plotësimi i strukturës organizative me staf të kualifikuar dhe përmbushjes së detyrave dhe funksioneve përkatëse të çdo pozicioni të lirë pune.</p> <p>Këto rekrutime janë realizuar me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive . Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në katëgorinë ekzekutive".</p> <p>Konkurimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të këtij komisioni, nga të cilët disa prej tyre ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, janë paguar në vlerën 10.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. Anëtarët e KPLP dhe KPND , janë paguar në vlerën 5.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. Këto shpenzime janë përballuar nga buxheti i Bashkisë Shkodër bazuar në planin vjetor të nevojës për rekrutime.</p> <p>Në bazë të planit vjetor për vitin 2016, janë realizuar këto procedura:</p> <p>-Janë zhvilluar 19 procedura për pranim në shërbim civil të grupuara sipas pozicioneve -Janë zhvilluar 31 procedura për ngritje në detyrë</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore. - Rekrutimi i Administratës Vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në kohë, në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve në fuqi duke garantuar plotësimin e standarteve në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe në bazë të planit vjetor të rekrutimeve . 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014" Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit. • Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet eksperiencë pune) • Hartimi i dokumentacionit përkatës • Ngritja e Komisioneve të Pranimit sipas rasteve • Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër • Zhvillimi i procedurave të testimit. • Emërimet 		
b) Rezultatet e pritshme		
<p>Në zbatim të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në katëgorinë ekzekutive".,VKM nr. 108 dt. 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimeve nëshërbimin civil" , Njesia e Burimeve Njerëzore përgatit planin vjetor të pranimeve për vitin pasardhës .Ky planifikimin vjetor për pranimin në shërbimin civil, përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil; • Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil; • Ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara në pikën "1" dhe "2" . <p>Kjo procedurë konkurimi zhvillohet në disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të këtij komisioni, nga të cilët disa prej tyre janë ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, paguhet në vlerën 10.000 lekë për çdo procedurë konkurimi për pranim në shërbimin civil dhe 5 000 mije lekë për procedurën e ngritjes në detyrë .Fondi për mbulimin e shpenzimeve të anëtarëve të KPP –së përballon nga buxheti i Bashkisë Shkodër bazuar në planin vjetor të nevojës për rekrutime.</p>		
c) Aktorët e mundshëm	c) Aktorët e mundshëm	
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	
e) Shpenzimet e llogaritura		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sig uri me	Ope rativ e	Tra nsfe rime	Kap itale
A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014" Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.						
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune)			150			
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës						
A.4	Ngritja e Komisioneve të Pranimit sipas rasteve						
A.5	Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër						
A.6	Zhvillimi i procedurave të testimit						
A.7	Emërimet						
	Shuma	150		150			
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë vitit 2017, 2018, 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 2.Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse					

Nr.3	Projekti: P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës	Llojet e programit: P1. Planifikim, Manaxhim, Administrim Funksioni: P1.F1 Administrata Vendore			
a) Përshkrim i shkurtër i projektit					
i. Situata					
<p>Nëpunësit civil trajnohen në kuadrin e përgjithshëm të programeve të trajnimit, të organizuara nga institucioni në përputhje me programet e përgjithshme të trajnimit. Nëpunësi civil mund të kryejë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tij, por vetëm për detyrën që ai kryen, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit .</p> <p>Trajnimi bëhet sipas planit të zbatimit të projektit të miratuar nga bashkia dhe asistimi i vazhdueshëm gjatë periudhës së implementimit.</p> <p>Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar disa trajnime në lidhje me menaxhimin e financave vendore ,për menaxhimin e mbetjeve urbane,trajnime te vijueshme profesionale të audituesve të brendshëm,trajnim mbi komunikimin dhe rëndësinë e tij ne institucione apo mjedise të biznesit,trajnim mbi antikorrupsionin dhe integritetin, trajnime mbi dixhitalizimin e arkivave për stafin e administratës.</p> <p>Gjithashtu trajnimi që po realizohet për Microsoft Office 365 do të ndihmojë stafin që të ketë një menaxhim më të suksesshëm të dokumentave dhe do t i ofrojë një punë më profesionale dhe të personalizuar institucionit të Bashkisë. Aktivizimi i këtij programi që fillon me instalimin e një sistemi operativ Ëindoës Server) deri në proceset mjaft teknike që janë krijimi i grup-përdoruesve, backup i sistemit, konfigurimi i klientëve (pc) etj</p>					
ii. Synimi i projektit					
Të krijojë vazhdimësi profesionale në administratën publike Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimit të punonjësve në përputhje me ligjin në fuqi.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza, vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për trajnim të nëpunësve të Bashkisë Shkodër. 2. Nënshkrimi i marrëveshjeve për zhvillimin e trajnimeve të stafit . 3. Vlerësimi i rezultateve në punë pas verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. 4. Identifikimi i nevojave. 					
b) Rezultatet e pritshme					
Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në funksion të rritjes së vazhdueshme profesionale për përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve. Krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient.					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse		Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	opera tive	kapit ale
A.1	Analiza, vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për trajnim të nëpunësve të Bashkisë Shkodër.				
A.2	Nënshkrimi i marrëveshjeve për zhvillimin e trajnimeve të stafit të ri dhe ekzistues të bashkisë dhe të niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj.				
A.3	Vlerësimi i rezultateve në punë pas verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave.				
A.4	Identifikimi i nevojave				
Shuma		200		200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	opera tive	kapit ale
A.1	Analiza, vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për trajnim të nëpunësve të Bashkisë Shkodër.				

A.2	Nënshkrimi i marrëveshjeve për zhvillimin e trajnimeve të stafit të ri dhe ekzistues të bashkisë dhe të niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj.		
A.3	Vlerësimi i rezultateve në punë pas verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave.	200	200
A.4	Identifikimi i nevojave		
Shuma		200	200

Nr. 4	Projekti: P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	Llojet e programit: P1 Planifikim, Manaxhim, Administrim Funksioni: P1.F1 Administrata Vendore
Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Parashikimi i shpenzimeve për shërbimet e nevojshme që Administrata Vendore ka ne funksionin e saj, ne përputhje me programin për Administrim, Menaxhim dhe Planifikim, zë një vend të rëndësishëm për mirë funksionimin dhe kryerjen e detyrave te përditshme të saj.</p> <p>Duke patur parasysh atë çfarë është bërë gjatë vitit 2016, kërkesat dhe nevojat që ka administrata për vazhdimësinë e punës te cilat tashmë kanë ndryshuar me ndarjen e re territoriale, renditen si më poshte vijon:</p> <p>Bashkia Shkodër ka nje marrëdhënie korrekte me Ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime Shkodër. Furnizimi me ujë I territorit të Bashkisë dhe Njësive Administrative ka pasur përmirësim por problematika vazhdon sidomos në Njësive Administrative ku duhet të vendosen matësja uji aty ku mungojnë apo nuk funksionojnë. Likuidimi I faturave te ujit është bërë korrekt në kohë Gjatë vitit 2016 është realizuar vendosja e matësave ne Bashkinë Shkodër (Gjendja Civile dhe Drejtoria e te Ardhurave) Gjithashtu Bashkia Shkodër ka nje marrëdhënie korrekte me OSHE si ne furnizimin me energji elektrike ashtu edhe në likuidim të faturave të energjisë, në përputhje me kontratat dhe matësat e energjisë të cilat gjithsesi duhet te jenë subjekt I kontrollit dhe verifikimit te vazhdueshëm</p> <p>Burimi I energjisë për ngrohjen e ambienteve të punës vazhdon të jetë me energji elektrike dhe me gaz të lëngshem. Gjate vitit 2016 nuk është realizuar blerja e gazit të lëngshëm për arësye se ka patur konsum më të vogel dimrin që kaloi, si pasojë e temperaturave më të larta dhe për pasojë rezultojnë gjendje në magazinë</p> <p>Shërbimet postare mbeten një mjet komunikimi I domosdoshem I Bashkisë Shkodër për tu parashikuar për vitin 2017. Ky shërbim mundëson dërgimin e dokumentacionit zyrtar te Bashkisë Shkodër, si domosdoshmëri e ushtrimit të funksioneve te saj. Për vitin 2016 nuk është realizuar shpenzimi I parashikuar si pasojë e kalimit të disa pagesave nga posta në banka si dhe nga akt-marrëveshja e re e lidhur me Posten Shqiptare me dt. 28.09.2016 ,ku thuhet që nga muaji Tetor Posta do te aplikojë nje komision 50 lekë në muaj per cdo person që përfiton nga skema e ndihmës ekonomike dhe PAK, duke hequr kështu komisionin prej 0.5% që është paguar nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Një formë tjetër komunikimi është edhe shpallja dhe publikimi i njoftimeve zyrtare në media. Media konsiderohet një kanal komunikimi shumë i rëndësishëm për njoftimin zyrtar të qytetarëve, bizneseve, institucioneve të tjera, etj., për shpallje vendesh të lira pune, për urime me raste festash te ndryshme kombëtare e fetare, për publikime të ngjarjeve, aktiviteteve kulturore e sportive, programeve dhe nismave të ndryshme të ndërmarrja nga Bashkia Shkodër. Ky shërbim është i domosdoshëm për komunikim i cili rrit transparencën, cilësinë dhe korrektesinë ndaj bashkëqytetarëve të Shkodrës. Ky shërbim, gjithashtu, shoqërohet me printime të ndryshme dokumentacionesh për nevojat e administratës si: fatura per arketim, flete gjoba per policine bashkiake etj.</p> <p>Administrimi, menaxhimi dhe planifikimi përfshin edhe shërbime të tjera të nevojshme siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Abonimi vjetor satelitor i nevojshëm për këshillim, informim dhe marrëdhënie me publikun • Tarifa parkimi për automjetet në shërbim të administratës të nevojshme për t'u shpenzuar në rastet e parkimit te tyre në qytete të tjera, kur ka udhëtime të administratës vendore për arsye pune jashtë qytetit të Shkodrës • Shpenzime të tjera për buqeta dhe kurora me lule të nevojshme për raste të ndryshme festash, ngjarjesh ceremoniale, datash përkujtimore, raste mortore, etj. për figura të njohura të artit, kulturës, sportit, arsimit, politikës së qytetit, etj. <p>Çdo vit në Bashkinë Shkodër kryhet sistematikisht rimbushja e fikeve të zjarrit në përmbushje të masave të sigurisë kundër zjarrit. Kjo realizohet në përputhje me specifikimeve teknike të nevojshme si: rimbushje me anhidrid karbonik CO₂, me valvol me pulsant dispozitiv sigurie. Gjate vitit 2016 eshte realizuar rimbushja e fikeve te zjarrit si dhe blerja e fikeve te zjarrit tavanore 6kg dhe 12 kg të cilat janë vendosur nën catinë e godinës së Bashkisë, Arkivës ,dhe zyrave të Gjendjes civile</p> <p>Aktivitetet kulturore dhe festat të cilat organizohen nga Bashkia Shkodër dhe festohen në qytetin e Shkodrës shpesh herë në përmblyllje te tyre shoqërohen edhe me hedhje të fishekzjarreve. Ky është një shërbim tjetër, i cili është realizuar nga Bashkia Qendër çdo vit dhe do të jetë edhe në vijim i nevojshëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe festave sipas parshikimeve të bëra paraprakisht nga drejtoritë përgjegjëse.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Të krijohen kushte normale pune dhe në përmirësim te vazhdueshëm për administratën në funksion të rritjes së performancës së saj në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit.</p> <p>Sigurimi i shërbimeve bazë (ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar,) për përmbushje të kushteve fizike normale për administratën vendore gjatë kryerjes së funksioneve dhe detyrave të tyre të përditshme.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Rishikim i kontratave të ujit te Njesive Administrative dhe Lagjeve si dhe lidhja e kontratave te reja për këto shërbime me Ujësjellës-Kanalizime Shkodër <ol style="list-style-type: none"> 1.1 Marrja dhe vlerësimi i kërkesave për këto shërbime nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. 1.2 Pergatitja e preventivave dhe dokumentacioneve përkatëse për të filluar procedurat për prokurim për secilin shërbim të nevojshëm. 2. Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara paraprakisht. <ol style="list-style-type: none"> 2.1 Furnizim me ujë i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative 		

2.2 Furnizim me energji elektrike i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative 2.3 Furnizimi me gaz të lëngshëm për ngrohje 2.4 Shërbime postare 2.5 Shërbime telefonie celulare 2.6 Shërbime të printimit dhe publikimit në media 2.7 Larje tapeta, automjete, etj. 2.8 Tarifë parking 2.9 Abonim satelitor 2.10 Shpenzime të tjera (buqeta, kurora, lule) 2.11 Rimbushje fikëse zjarri 2.12 Blerje Fishekzjarre					
b) Rezultatet e pritshme					
Furnizim me ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, , publikime në media dhe printime, pagesë tarifash parkingu dhe abonimi satelitor dhe sigurimin e shërbimeve të tjera të domosdoshme duke krijuar kushte fizike optimale në punë për administratën vendore që ofron shërbimin për qytetarin, vizitorin, biznesin, të cilët marrin shërbimin pranë ambjenteve të Bashkisë Shkodër Njësive Administrative dhe Lagjeve					
c) Aktorët e mundshëm 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse			d) Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet sipas aktiviteteve 2017		Totali (000/lek)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operativ e	Kapitale
A.1	Procedurat e rishikimit të kontratave dhe lidhja e kontratave të reja për shërbimet e mësipërme				
A.2	Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara paraprakisht				
A.2.1	Furnizim me ujë i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative	700		700	
A.2.2	Furnizim me energji elektrike i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative	3500		3500	
A.2.3	Furnizimi me gaz të lëngshëm për ngrohje	600		600	
A.2.4	Shërbime postare	950		950	
A.2.5	Shërbime telefonie celulare	120		120	
A.2.6	Shërbime të printimit dhe publikimit në media	140		140	
A.2.7	Larje tapeta, automjete,tarife parkingu,abonim satelitor	80		80	
A.2.8	Shpenzime të tjera (buqeta, kurora, lule)	100		100	
A.2.9	Rimbushje fikëse zjarri	340		340	
A.2.10	Blerje Fishekzjarre	350		350	
Shuma		6880		6880	
Shpenzimet sipas aktiviteteve 2018		Totali (000/lek)	Nga kjo :		
			Paga sigurime	Operativ e	Kapitale
A.1	Procedurat e rishikimit të kontratave dhe lidhja e kontratave të reja për shërbimet e mësipërme				
A.2	Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara paraprakisht				
A.2.1	Furnizim me ujë i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative	700		700	
A.2.2	Furnizim me energji elektrike i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative	3500		3500	
A.2.3	Furnizimi me gaz të lëngshëm për ngrohje	600		600	
A.2.4	Shërbime postare	800		800	
A.2.5	Shërbime telefonie celulare	120		120	
A.2.6	Shërbime të printimit dhe publikimit në media	200		200	
A.2.7	Larje tapeta, automjete, tarifë parkingu,abonim satelitor	100		100	
A.2.8	Shpenzime të tjera (buqeta, kurora, lule)	100		100	
A.2.9	Rimbushje fikëse zjarri	340		340	
A.2.10	Blerje Fishekzjarre	350		350	

Shuma		6810		6810	
Shpenzimet sipas aktiviteteve 2019		Totali(000/lek)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Procedurat e rishikimit të kontratave dhe lidhja e kontratave të reja për shërbimet e mësipërme				
A.2	Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara paraprakisht				
A.2.1	Furnizim me ujë i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative	700		700	
A.2.2	Furnizim me energji elektrike i Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative	3500		3500	
A.2.3	Furnizimi me gaz të lëngshëm për ngrohje	600		600	
A.2.4	Shërbime postare	900		900	
A.2.5	Shërbime telefonie celulare	120		120	
A.2.6	Shërbime të printimit dhe publikimit në media	200		200	
A.2.7	Larje tapeta, automjete, tarifë parkingu, abonim satelitor	100		100	
A.2.8	Shpenzime të tjera (buqeta, kurora, lule)	100		100	
A.2.9	Rimbushje fikëse zjarri	340		340	
A.2.10	Blerje Fishekzjarre	350		350	
Shuma		6910		6910	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2017,2018,2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse			

Nr.5	Projekti: P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	Llojet e programit: P1. Planifikim, Manaxhim, Administrim Funksioni: P1.F1 Administrata Vendore		
a) Përshkrim i shkurtër i projektit				
i. Situata				
Aktualisht sasia e materialeve të kancelarisë dhe shtypshkrimet nuk përmbushin nevojat e Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative në përbërje të saj. Mungesa në materiale sjell pasoja të rënda në përmbushjen e detyrave. Si pasojë e rritjes së kapaciteteve, rritjes së numrit të personelit dhe shtimit të volumit të punës, kërkohet një shtesë në sigurimin e materialeve të domosdoshme për kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve. Rritja e kërkesës për materiale të kancelarisë dhe blerjeve të dokumentacionit (shtypshkrime, fotokopjime, libërlidhja e buxhetit) është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Shkodër dhe Njësitet Administrative.				
ii. Synimi i projektit				
Të rritet performanca në punë e administratës së Bashkisë. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, dhe bojëra për printera e fotokopje dhe shtypshkrime, që t'u mundësojë punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i kërkesës për materiale 2. Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet 3. Zbatimi procedurave tenderuese <ol style="list-style-type: none"> 3.1 Blerje kancelarie letër, bojë printeri dhe fotokopje 3.2 Blerje dokumentacione (shtypshkrime) 4. Marrja në dorëzim dhe magazinimi i materialeve 5. Shpërndarja sipas planit të aktiviteve të projektit 6. Sigurimi dhe furnizimi sipas kërkesave 				
b) Rezultatet e pritshme				
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi kushteve të punës dhe përmbushja e detyrave në kohë për administratën e Bashkisë ashtu dhe për Njësitet Administrative • Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në punë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë siç është furnizimi vazhdueshëm me kancelari, letër dhe bojë për printera e fotokopje, dhe shtypshkrime për punonjësit. • Rritjen e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së punës në shërbim të komunitetit. 				
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse		Bashkia e Shkodrës		
e) Shpenzimet e llogaritura				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
				kapitale
A.1	Identifikimi i kërkesës për materiale			
A.2	Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet			
A.3	Zbatimi procedurave tenderuese			
	A.3.1	Blerje kancelarie letër, bojë printeri dhe fotokopje	10000	10000
	A.3.2	Blerje dokumentacione (shtypshkrime)	800	800
A.4	Marrja në dorëzim dhe magazinimi i materialeve			
A.5	Shpërndarja sipas planit të aktiviteve të projektit			
A.6	Sigurimi dhe furnizimi sipas kërkesave			
Shuma		10800		10800
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
				kapitale

A.1	Identifikimi i kërkesës për materiale				
A.2	Vlerësimi i kërkesave në përputhje me kapacitetet				
A.3	Zbatimi procedurave tenderuese				
A.3.1	Blerje kancelarie letër, bojë printeri dhe fotokopje	10000		10000	
A.3.2	Blerje dokumentacione (shtypshkrime)	600		600	
A.4	Marrja në dorëzim dhe magazinimi i materialeve				
A.5	Shpërndarja sipas planit të aktiviteteve të projektit				
A.6	Sigurimi dhe furnizimi sipas kërkesave				
Shuma		10600		10600	

Nr.6	Projekti:P1.F1.O2.A3 Shërbim higjeno-sanitar për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	Llojet e programit: P1 Planifikim, Manaxhim, Administrim Funksioni: P1.F1 Administrata Vendore			
a) Përshkrim i shkurtër i projektit					
i. Situata					
<p>Materialet e pastrimit janë të domosdoshme për të arritur në një standart të unifikuar të pastërtisë në ambientet e punës Që të punosh në mënyrë eficiente dhe me profesionalizëm në zyrë duhet të kesh ambientet e pastërta, të rregullta dhe që pasqyrojnë dhe ofrojnë kushte sipas standarteve për mbarëvajtjen normale të punës. Për këte qëllim do krijohen mjedise pune të përshtatshëm ku niveli i pastërtisë të përmbushë standartet higjeno-sanitare në ambientet e godinave të Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative në përbërje të saj.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Të sigurohen ambiente pune sipas standarteve higjeno – sanitare në funksion të një performance sa më të lartë dhe përmirësimin e kushteve të punës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
